

CONVENTIO**inter Apostolicam Sedem et Rempublicam Albaniae.****Accordo
fra la Santa Sede
e
la Repubblica di Albania**su alcune questioni economiche
e tributarie

La Repubblica di Albania e la Santa Sede nella comune volontà di rafforzare i rapporti reciproci, richiamandosi ai principi internazionalmente riconosciuti della libertà di coscienza e di religione, considerando l'importante contributo sociale, morale e storico della Chiesa Cattolica nella vita della nazione, con l'intenzione di definire un quadro legale pertinente per il normale andamento delle attività della Chiesa Cattolica in Albania, hanno convenuto sull'opportunità di addivenire ad un Accordo per meglio regolamentare alcune questioni di natura economica e tributaria.

Pertanto, concordano quanto segue:

Articolo 1

La Repubblica di Albania garantisce il diritto riconosciuto alla Chiesa Cattolica in Albania di possedere e amministrare autonomamente beni e risorse economiche confacenti allo svolgimento della propria missione.

**Marrëveshje ndërmjet
Republikës së Shqipërisë
dhe
Selisë së Shenjtë**mbi disa çështje ekonomike
dhe tatimore

Republika e Shqipërisë dhe Serbia e Shenjtë me vullnetin e përbashkët për të forcuar marrëdhëniet reciproke, duke iu referuar parimeve të njohura në shkallë ndërkombëtare të lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë, duke vlerësuar kontributin e rëndësishëm shoqëror, moral dhe historik të Kishës Katolike në jetën e Vendit, me qëllimin për të përcaktuar një kuadër ligjor përkatës për ecurinë normale të veprimtarive të Kishës Katolike në Shqipëri, u morën vesh mbi nevojën për të arritur në një Marrëveshje për të rregulluar më mirë disa çështje me natyrë ekonomike dhe tatimore.

Palët bien dakort përsa vijon:

Neni 1

Republika e Shqipërisë garanton të drejtën që i është njohur Kishës Katolike në Shqipëri për të zotëruar dhe për të administruar në mënyrë të pavarur të mira dhe burime ekonomike të nevojshme për zhvillimin e misionit të vet.

Articolo 2

La Chiesa Cattolica può liberamente procurarsi e ricevere aiuti materiali o finanziari provenienti da fedeli e donatori, anche dall'estero. Essa può organizzare collette pubbliche e ricevere offerte che serviranno per lo svolgimento della sua missione. Le sovvenzioni finanziarie di qualunque genere e ogni altra entrata legittima, come pure le donazioni materiali, destinate alla realizzazione della propria missione, non saranno soggette ad alcuna tassa o imposta.

Articolo 3

Sono esenti dalla tassa sull'edificio gli immobili di proprietà o in uso della Chiesa Cattolica, dei suoi Enti e delle sue Istituzioni contemplate nel Codice di Diritto Canonico, costituite dalle competenti Autorità ecclesiastiche come persone giuridiche ecclesiastiche o riconosciute come Organizzazioni senza scopo di lucro della Chiesa Cattolica e registrate presso i competenti organi statali albanesi, nei casi in cui essi siano usati per il culto, il governo e l'amministrazione ecclesiastica, l'attività pastorale, umanitaria e caritativa, la formazione dei sacerdoti e dei religiosi, l'insegnamento della teologia e di altre scienze ecclesiastiche, come pure per l'abitazione dei ministri di culto e del personale religioso e laico a servizio della Chiesa.

Neni 2

Kisha Katolike lirisht mund të sigurojë dhe të marrë ndihma materiale ose financiare të ardhura nga besimtarë dhe dhurues, edhe nga jashtë shtetit. Ajo mund të organizojë mbledhje ndihmash publike dhe të pranojë lëmosha të cilat do t'i shërbejnë për zhvillimin e misionit të saj. Subvencionet financiare të çfarëdo lloji dhe çdo e ardhur tjetër e ligjshme, si edhe donacionet materiale, të destinuar për të realizuar misionin e vet, nuk do të nënshtrohen asnjë lloj takse apo tatimi.

Neni 3

Janë të përjashtuara nga taksa mbi ndërtesën, ndërtesat në pronësi ose në përdorim të Kishës Katolike, të Enteve të saj dhe të Institucioneve të saj të parashikuara në Kodin e së Drejtës Kanonike, të themeluara nga Autoriteti kompetent kishtar si persona juridikë kishtar ose të njohura si Organizata pa qëllim fitimi të Kishës Katolike dhe të regjistruara pranë organeve kompetente shtetërore shqiptare, në rastet kur ato përdoren për ushtrimin e kultit, drejtimin dhe administrimin kishtar, veprimtarinë baritore, humanitare dhe bamirëse, formimin e meshtarëve dhe të rregulltarëve, mësimin e teologjisë dhe të shkencave të tjera kishtarë, si dhe për banimin e mbarështuesve të kultit dhe të personelit fetar dhe laik në shërbim të Kishës.

Articolo 4

Le esenzioni previste all'art. 3 del presente Accordo non si applicheranno qualora gli immobili in esso menzionati venissero utilizzati per attività di lucro, nel qual caso si ricorrerà alla legislazione vigente, tenendo conto delle tabelle immobiliari fissate dai locali organi amministrativi dello Stato.

Articolo 5

Per gli edifici e gli ambienti adibiti ad attività educative e scolastiche, anche universitarie e post-laurea, sociali e sanitarie, di proprietà o in uso degli Enti e delle Istituzioni di cui all'Articolo 3 del presente Accordo si applicherà la tariffa stabilita dagli organi amministrativi locali che non dovrà essere superiore a quella stabilita per le altre Organizzazioni senza scopo di lucro che svolgano le stesse attività. Tale tariffa si stabilirà computando soltanto la superficie dell'ambiente nel quale si svolgono le attività contemplate.

Articolo 6

I beni, mobili e immobili, di proprietà della Chiesa Cattolica o dei suoi Enti, utilizzati per l'esercizio del culto, il governo e l'amministrazione ecclesiastica, l'attività pastorale, umanitaria e caritativa, la formazione dei sacerdoti e dei religiosi, come pure per l'abitazione dei mini-

Neni 4

Përjashtimet e parashikuara në Nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje nuk do të zbatohen në rast se ndërtesat në të, të përmendura, do të përdoren për veprimtari që kanë qëllim fitimi. Në këtë rast do të zbatohet legjislacioni në fuqi duke mbajtur parasysh tarifat e caktuara prej organeve të pushtetit lokal.

Neni 5

Për ndërtesat dhe ambientet e caktuara për veprimtari edukative dhe shkollore, edhe universitare e pasuniversitare, shoqërore dhe shëndetësore, ne pronësi ose në përdorim të Enteve dhe të Institucioneve të parashikuara në Nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, do të zbatohet tarifa e caktuar prej organeve të pushtetit lokal, e cila nuk duhet të jetë më e madhe se tarifa e përcaktuar për Organizatat e tjera pa qëllim fitimi që zhvillojnë të njëjtat veprimtari, duke llogaritur vetëm sipërfaqen e ambientit në të cilin zhvillohen veprimtaritë e parashikuara.

Neni 6

Pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të Kishës Katolike ose të Enteve të saj, të përdorura për ushtrimin e kultit, drejtimin dhe administrimin kishitar, veprimtarinë baritore, humanitare dhe bamirëse, formimin e meshtarëve dhe të rregulltarëve, si

stri di culto e del personale religioso e laico a servizio della Chiesa, saranno esenti dal pagamento dell'imposta di successione o di passaggio di proprietà, nel caso di donazioni fra la Chiesa Cattolica e i suoi Enti o fra gli Enti stessi previsti all'art. 3 di questo Accordo. La destinazione di detti beni sarà comprovata dai relativi atti notarili.

Articolo 7

Sono esenti dall'obbligo del versamento contributivo di assicurazione sociale e sanitaria i ministri di culto e il personale religioso e laico a servizio della Chiesa, di nazionalità straniera, regolarmente residenti in Albania, i quali non beneficiano di alcun reddito o compenso per l'esercizio della loro attività a servizio della Chiesa, anche in qualità di fondatori, dirigenti o rappresentanti legali di Enti o Istituzioni di cui all'art. 3 del presente Accordo, e che hanno già versato tali contributi nei Paesi di provenienza. Ai summenzionati soggetti spetterà l'onere della dimostrazione documentale presso gli organi statali competenti.

Articolo 8

Le persone giuridiche ecclesastiche della Chiesa Cattolica, contemplate nel codice di Diritto Cano-

dhe për banimin e mbarështuesve të kultit dhe të personelit fetar dhe laik në shërbim të Kishës do të përjashtohen nga pagimi i taksës së trashëgimisë ose të kalimit të pasurisë, në rastin e dhurimeve mes Kishës Katolike dhe Enteve të saj ose mes vetë Enteve të parashikuara në Nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje. Destinacioni i pasurive të sipërpërmendura do të provohet me aktet noteriale përkatëse.

Neni 7

Përjashtohen nga detyrimi i derdhjes së kontributeve për sigurim shoqëror dhe shëndetësor mbarështuesit e kultit dhe personeli fetar dhe laik në shërbim të Kishës, me kombësi të huaj, me banim të rregullt në Shqipëri, të cilët nuk përfitojnë asnjë të ardhur apo shpërblim për kryerjen e veprimtarisë së tyre në shërbim të Kishës, edhe në cilësinë e themeluesve, të drejtuesve apo të përfaqësuesve ligjor të Enteve apo Institucioneve të parashikuara në Nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, dhe që i kanë derdhur më parë këto kontribute në vendet e origjinës. Subjekteve të sipërpërmendura do tu takojë detyrimi për ta provuar këtë me dokumente pranë organeve shtetërore kompetente.

Neni 8

Personat juridikë kishtar të Kishës Katolike, të parashikuara në Kodin e së Drejtës Kanonike ose

nico o riconosciute dalla competente Autorità ecclesiastica e registrate presso i corrispondenti organi statali, per quanto riguarda le loro attività di carattere istituzionale, come il culto, il governo e l'amministrazione ecclesiastica, l'attività pastorale, umanitaria e caritativa, la formazione dei sacerdoti e religiosi, l'insegnamento della teologia e altre scienze ecclesiastiche, non sono obbligate a tenere i registri contabili ed a sottostare agli *standard* amministrativi previsti nelle leggi e negli atti normativi subordinati alla legge in vigore. Di conseguenza, per tali attività esse non hanno l'obbligo di presentare il bilancio contabile annuale agli organi competenti dello Stato e neppure di depositarlo presso gli organismi statali stabiliti dalla legislazione vigente.

Articolo 9

In caso di questioni incerte, irrisolte e contese che riguardano la Chiesa Cattolica in Albania e i suoi Enti e Istituzioni come persone giuridiche ecclesiastiche o riconosciute come Organizzazioni senza scopo di lucro della Chiesa Cattolica e registrate presso i competenti organi statali albanesi, la Chiesa Cattolica in Albania e l'autorità competente nella Repubblica d'Albania costituiranno una commissione bilaterale «ad hoc» con il compito di trovare soluzioni accettabili da entrambe le parti.

të njohura prej Autoritetit kompetent kishtar dhe të regjistruara pranë organeve shtetërore përkatëse, përsa i takon veprimtarive të tyre me karakter institucional si: ushtrimi i kultit, drejtimi dhe administrimi kishtar, veprimtaria baritore, humanitare dhe bamirëse, formimi i meshtarëve dhe i rregulltarëve, mësimi i teologjisë dhe i shkencave të tjera kishtarë, nuk janë të detyruar të mbajnë regjistrat kontabël dhe t'u nënshtrohen standarteve administrative të parashikuara në ligjet dhe në aktet nënligjore në fuqi. Si pasojë, për të tilla veprimtari ato nuk e kanë detyrimin që të paraqesin bilancin kontabël vjetor tek organet kompetente shtetërore dhe as ta depozitojnë atë pranë organizmave shtetërore të caktuara nga legjislativimi në fuqi.

Neni 9

Në rast çështjesh të papërcaktuara, të pazgjidhura dhe të diskutueshme që kanë të bëjnë me Kishën Katolike në Shqipëri dhe me Entet dhe Institucionet e saj si persona juridikë kishtar ose të njohura si Organizata pa qëllim fitimi të Kishës Katolike dhe të regjistruara pranë organeve kompetente shtetërore shqiptare, Kisha Katolike në Shqipëri dhe autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë do të formojnë një komision dypalësh «ad hoc» me detyrën për të gjetur zgjidhje të pranueshme nga të dyja palët.

Articolo 10

Nel caso in cui, per varie cause o circostanze, si renda necessario in futuro regolamentare altre questioni in materia economica e tributaria non contemplate nel presente Accordo, le parti firmatarie converranno per la conclusione di Accordi Addizionali.

Articolo 11

Questo Accordo sarà vigente al momento della reciproca notifica dell'adempimento, presso ciascuna Parte, delle procedure interne necessarie perché entri in vigore.

Questo Accordo verrà disdetto allorché una Parte notificherà all'altra la sua decisione per iscritto. L'Accordo sarà abrogato 90 (novanta) giorni dopo la data di notificazione.

Firmato a Tirana il 3 Dicembre 2007.

Per la Santa Sede

S.E. Mons. GIOVANNI BULAITIS
Nunzio Apostolico

Neni 10

Në rast se në të ardhmen, për shkaqe ose rrethana të ndryshme, do të bëhet i nevojshëm rregullimi i çështjeve të tjera me natyrë ekonomike dhe tatimore të paparashikuara në këtë Marrëveshje, palët nënshkruese do të bien dakort për të firmosur Marrëveshje Shtesë.

Neni 11

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në momentin e njoftimit reciprok për plotësimin nga ana e secilës palë të procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi.

Kjo Marrëveshje do të zgjidhet nëse njëra palë do t'i njoftojë palës tjetër vendimin saj me shkrim. Marrëveshja do të pushojë së ekzistuari mbas 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga dita e njoftimit.

Bërë në Tirane, më 3 Dhjetor 2007.

Për Republikën e Shqipërisë

ZOTI RIDVAN BODE
Ministër i Financave

Quae Conventio inter Apostolicam Sedem et Albaniae Rempublicam die III mensis Decembris anno MMVII subsignata est, eadem XII die mensis Februarii anno MMVIII a Reipublicae Albaniae Praeside et XXII die mensis Februarii anno MMVIII a Summo Pontifice Benedicto XVI rata habita est.

Postquam Ratihabitio mutuo ad normam articuli decimi primi eiusdem Conventionis est communicata, eadem vigere coepit.